



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	11.07.2025
REFERENC-Ë:	25/3829/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Gurëbardhi" Sh.p.k. Klinë, Eksploatim i gurit gëlqeror, Tarllabuq, Vushtrri
CC:	Komisioni për shqyrtimin e kërkesës për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Arkivës së MMPHI-së
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për vazhdimin e Lejes Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për vazhdimin e Lejes Mjedisore të operatorit "Gurëbardhi" Sh.p.k. Klinë, për veprimtarinë: Eksploatim i gurit gëlqeror, Tarllabuq, Vushtrri.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur:

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 25/3829/MMPHI
Datë: 11.07.2025

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafët 1, 2 dhe 4 të nenit 12, nenin 13, 16 dhe 17 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr.04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

Aprovohet kërkesa me Nr.Prot.25/3829/MMPHI, e operatorit "Gurëbardhi" Sh.p.k. Klinë, për vazhdimin e Lejes Mjedisore, për veprimtarinë: Shfrytëzim i gurit gëlqeror, në pjesët e ngastrave kadastrale, nr.P-70202065-00040, P-70202065-00041-0, P-70202065-00042-0, P-70202065-00043-0, P-70202065-00045-0, në sipërfaqe prej 8.24.61 ha apo (82,461 m² zona kadastrale Tarllabuq, Vushtrri, sipas Vendimit të Pëlqimit Mjedisor me Nr.:16/5429/1-ZSP/28/17, të lëshuar me datë: 02.02.2017

Operatori obligohet:

- Të bënë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike;
- Të mirëmbahet rrethoja e fushës eksploatuese;

- T'i përmbahet kushteve të shfrytëzimit të gurit gëlqeror, sipas përshkrimit në aplikacion;
- Për sistemin menaxhues mjedisore të këtë personin e profilit mjedisor;
- Vazhdimisht të bëhet spërkatja me ujë e rrugëve të pa asfaltuara, të cilat shfrytëzohen për bartjen e gurit gëlqeror nga fusha eksploatuese deri te lokacioni ku kryhet aktiviteti i thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror;
- Pas përfundimit të aktivitetit të bëhet rehabilitimi dhe rikultivimi i zonës sipas kriterëve ligjore dhe përshkrimit në aplikacion;
- Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike e që mund të ketë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës, të njoftoj MMPHI;

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Mjedisore për operatorin "Gurëbardhi" Sh.p.k. Klinë, për vazhdimin e Lejes Mjedisore, për veprimtarinë: Shfrytëzim i gurit gëlqeror, në pjesët e ngastrave kadastrale, nr.P-70202065-00040, P-70202065-00041-0, P-70202065-00042-0, P-70202065-00043-0, P-70202065-00045-0, në sipërfaqe prej 8.24.61 ha apo (82,461 m² zona kadastrale Tarllabuq, Vushtrri, sipas Vendimit të Pëlqimit Mjedisor me Nr.:16/5429/1-ZSP/28/17, të lëshuar me datë: 02.02.2017, MMPHI konstaton se operatori i plotëson kriteret e parapara me Udhëzim Administrativ(MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Operatori ka bashkangjitur dokumentet:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr. 13/99, te dt. 30.09.2022, për përcaktimin e kriterëve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit, NUI 811243211, datë: 17.05.2016, të lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë;
- Pëlqim Mjedisor me Nr.:16/5429/1-ZSP/28/17, të lëshuar me datë: 02.02.2017 ;
- Lejen për aktivitete të veçanta për sortues, 1722/KPMM/2017, me Nr.Prot.3599, të lëshuar nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale;
- Njoftim/Pëlqim, 08Nr.230, datë: 08.04.2025, të lëshuar nga Komuna e Vushtrisë

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), duke u bazuar në nenin 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafët 1, 2 dhe 4 të nenit 12, nenin 13, 16 dhe 17 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr.04/2022 për Leje Mjedisore, merrë vendim që operatorit t'i lardekur t'i vazhdohet Leja Mjedisore.

Leja Mjedisore lëshohet për periudhën pesë (5) vjeçare, në përputhje me paragrafin 4 të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr.04/2022 për Leje Mjedisore.

Leja Mjedisore mund të revokohet, pezullohet apo shfuqizohet në çdo kohë në rast se:

- Pëlqimet apo lejet paraprake mbi bazën e të cilave është lëshuar leja mjedisore janë revokuar, pezulluar apo shfuqizuar;
- Vërtetohet se pala nuk i ka respektuar obligimet e përcaktuara në leje mjedisore;
- Nëse konstatohet se operatori, ka dhënë shënime të pa sakta dhe deklarime të rrejshme;
- Nëse operatori nuk ka zbatuar dispozitat ligjore të këtij Udhëzimi Administrativ dhe legjislacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Izedin Bytyqi

U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së

Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Vushtrri;
- DMMU-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së